



Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në Asociacionin Rinor për të Drejtat e Njeriut (YAHR), vlerëson se problemet me KKSB-në në këtë komunë nuk kanë të sosur. Ndërkohë që kur kanë mbetur edhe pak ditë të mbahet mbledhja e radhës, ai po mendon që së bashku me anëtarët e tjerë të bojkotojnë mbledhjen, në shenjë pakënaqësie

Mospagesa rrezikon funksionalitetin e Këshillit të Sigurisë në Bashkësi

Arian Duriqi

LIPJAN, 5 QERSHOR – Injorimi i bërë nga organet komunale, përkatësisht Zyra e personelit për të paguar mëditjet për kontributin e tyre mund të bëhet shkak i një bojkoti, në mënyrë demonstrative për mbledhjen e ardhshme të Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi në Lipjan.

KKSB-ja kështu rrezikon funksionalitetin pikërisht për mungesë mëditjesh që nuk janë paguar për këtë organ prej kohësh, edhe pse kjo çështje ishte rregulluar me një udhëzim administrativ nga MPB-ja para gati një viti. Anëtarët e KKSB-së, ndërkaq, po shprehen kategorikë se mospagesa e mëditjeve e vë pikëpyetje funksionimin e organit në fjalë.

Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në Asociacionin Rinor për të Drejtat e Njeriut (YAHR), vlerëson se problemet me KKSB-në në këtë komunë nuk kanë të sosur, ndërkohë që kur kanë mbetur edhe pak ditë të mbahet mbledhja e radhës ai po mendon që së bashku me anëtarët e tjerë të bojkotojnë mbledhjen, në shenjë pakënaqësie.

“Anëtarët e KKSB-së, të gjithë ata që nuk marrin paga nga buxheti i shtetit, nuk pranojnë të dalin shumë haptas, por e pohojnë nën zë se do t'i bashkohen bojkotit, i cili do të nisë dhe do të mbarojë kur të realizohen mëditjet. Ndryshe, do të ishte mirë sikur të mendohej më shpejt puna e mëditjeve, sepse ky është një problem që duhet zgjidhur”, ka thënë Krasniqi, i cili përfaqëson në KKSB organizatën që drejton.

Dhe, meqë tashmë edhe Udhëzimi administrativ e rregullon punën e mëditjeve, Krasniqi ka kërkuar të realizohen të drejtat e anëtarëve para se të shfaqet rreziku për mosfunksionim të organit.

“Vazhdimisht kemi qenë pjesëmarrës në mbledhjet e këtij organi, edhe pse nuk kemi marrë asnjëherë mëditje për këtë kontribut. Dhe, meqë tashmë nuk kemi të bëjmë me një punë vullnetare, por që paguhet nëpërmjet një udhëzimi administrativ nga MAPL-ja dhe pjesëmarrja është e rregulluar edhe me ligj, kërkojmë të drejtën tonë”, ka thënë ai. Ndërkohë që ka edhe anëtarë të tjerë që kanë pakënaqësi dhe që përkrahin secilën iniciativë për të realizuar të drejtën për pagesë. “Kemi

kërkuar disa herë sqarime dhe arsye për mospagesën e mëditjeve, janë dhënë afate e afate, madje ka ardhur para një viti edhe një udhëzim nga MAPL-ja dhe prapë nuk është zgjidhur kjo çështje. Prandaj duhet gjetur rrugë për ta zgjidhur problemin”, ka thënë Besim Limani, anëtar tjetër në KKSB-në e Lipjanit.

Ndryshe, edhe para një muaji ishte ngritur problemi dhe ish-in ngritur akuza nga anëtarët e KKSB-së për Zyrën e personelit se nuk po procedon mëditjet e anëtarëve.

Mirëpo, nga ana tjetër Zyra e personelit duke u përgjigjur nëpërmjet Zyrës së informacionit publik nuk pati marrë fajin përsipër duke hedhur poshtë akuzat se kjo çështje ka të bëjë me ta.

“Zyra e personelit në përgjigjen që ka dhënë pikërisht për këtë çështje është deklaruar se nuk i kanë proceduar asnjëherë mëditjet e tilla, as më herët e as tashmë. Realisht thonë se nuk është çështje e tyre pagesa e mëditjeve, por që kjo pagesë duhet të rregullohet nga niveli qendror”, ka thënë Hasan Luma, shef i ZIP-it në Lipjan.

© KOHA Ditore

Komisioni komunal zvarrit emërtimin e rrugëve prej një viti

Bejtullah Sokoli

RAHOVEC, 5 QERSHOR – Komisioni komunal për emërtim rruoësh



Belinci e Da

SHTIME, 5 MAJ – Davidovc kanë m... LDD. Arben Ader... hiqet deponia e m... syetim se nuk është bërë kjo dep... dheut, tullave, bllo... cila po u sjell shum... Për këtë çështje In... andaj akuzojmë l... ndërkaq kërkojmë... shit, sepse kjo d... banimeve”, ka kë... Shaban Halimi, kë... “Mendoj se për... ciklimi i mbeturina... kërkesat e banorë... Nga ana tjetër F... Shërbimeve Publi... ponive të mbetur... sisht kësaj Shtimja... ka qytetarë të pap...

“Jesus

MALISHEVË, 5... “Jesus Christ”, Stoc... një marrëveshje m... ndihmë në ndërtim... Kjo OJQ për këtë... rosh. Kryetari i M... Christ-it”, për këtë... i cili është lokalitet... “Jesus Christ”, ka t... i mjeteve që mund... në ndërtimin e këti... jellësit do të kryhet... muna e Malishevë... marrëveshjes, bash... ishme edhe sekret...

Drenasi hedh

DRENAS, 5 QERSHOR – afatmesme buxhet... torëve komunale p... marrëse.

Hamdi Krasniqi, propozuar buxheti euro, që krahasuar qind, e që shprehu i Drenasit, Nexhat zimet operative për